



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 25, datë 09.07.2024

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË DIGËN E ZADEJËS HEC VAU I DEJËS”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VAU I DEJËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i impiantit fotovoltaik në digën e Zadejës Hec Vau i Dejës”, me vendndodhje në Bashkinë Vau i Dejës, me subjekt zhvillues Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH).
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vau i Dejës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

*[Signature]*  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

*[Signature]*  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 21/02/2025